

EKSPOZE MBI TEZËN E NIVELIT MASTER
NË INTEGRIME EUROPIANE DHE
ADMINISTRATË PUBLIKE

ADMINISTRIMI I SEKTORIT SHËNDETËSOR NË KOSOVËN E PAS 1999

NGA

SHKELZEN MUSLIU



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKE
INTEGRIME EVROPIANE DHE ADMINISTRATË PUBLIKE

PRISHTINË
SHKURT, 2022

“ADMINISTRIMI I SEKTORIT SHËNDETËSOR NË KOSOVËN E PAS 1999”

Mentor: Prof. Ass. Dr. Anton Vukpalaj

~ Përmbledhje

Me ndryshimet e bëra nga shuarja e ish-Jugosllavisë dhe shkatërrimin masiv gjatë periudhës së luftës si faktorë kryesor, gjendja në sektorin shëndetësor në Kosovën e pasluftës kaloi në një gjendje kritike. Zhvillimi i sektorit të shëndetësisë pas konfliktit të vitit 1999 si dhe pas pavarësimit në 2008 ka konsistuar në një interesim të ulët nga ana e qeverive në pushtet. Mungesa e një qasjeje serioze ndaj sektorit shëndetësor ka ndikuar që ky sektor, me rëndësi primare, të degradohet me përmasa shqetësuese, ku ndër të tjera, karakterizohet si një sektor që ofron shërbime të kualitetit të ulët, korrupsion të lartë dhe konflikt sistematik të interesit. Reformat e proklamuar nga qeveritë e njëpasnjëshme për më shumë se 10 vite nuk arrijnë të zbatohen dhe si rezultat ky sektor mbetet i pazhvilluar në nivelin që do të duhej të ishte, dhe nën ndikimin e grupeve të ngushta të interesit, çofshin ato grupe politike dhe apo korruptive. Ndonëse i proklamuar si prioritet qeveritar si dhe ndër premtimet kyçe të politikanëve gjatë çdo fushate zgjedhore, ky sektor ka mbetur jashtë angazhimit të përgjegjshëm dhe sistematik. Problemet kyçe me të cilat përballët çdo ditë ky sektor mbesin të lidhura me menaxhimin dhe administrimin e tij, burimet e kufizuara të financimit, sistemin e informimit shëndetësor dhe sistemin e sigurimeve shëndetësore. Ky punim synon të analizojë administrimin dhe menaxhimin e sektorit shëndetësor në Kosovë në tri periudha të ndryshme kohore, atë të pas luftës së vitit 1999, pas pavarësimit të Kosovës në vitin 2008, dhe periudhën pandemike 2020-2021. Vëmendje e veçantë i është kushtuar ndryshimeve që e kanë karakterizuar këtë sektor të rëndësishëm shtetëror, andaj një pjesë e konsiderueshme e këtij studimi, fokusohet në analizimin e gjendjes së këtij sektori në secilën periudhë kohore. Megjithëse Kosova ka arritur të përmirësojë ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor nga momenti i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, ende ka shumë hapësirë për përmirësime me qëllim përafrimin e këtij sektori me rajonin e aq më tepër me Bashkimin Evropian, në të cilin aspiron të antarësohet në të ardhmen.

~ Qëllimi i punimit

Qëllimi i këtij punimi konsiston në përshkrimin e ndryshimeve të sektorit shëndetësor në Kosovë në 22 vitet e fundit duke ndërtuar një rrjedhë kronologjike të ndryshimeve që pësuan që nga koha e ish-Jugosllavisë e deri në ditët e sotme, respektivisht në muajin nëntor të vitit 2021 kur edhe përfundoi hulumtimi për realizimin e këtij punimi. Në punim në veçanti janë analizuar tri periudha kohore, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë (një kapitull të tërë) menaxhimit të sektorit shëndetësor në periudhën pandemike, meqenëse në këtë kohë, ky sektor ka zënë rëndësinë më të madhe të sektorëve shtetërorë, në Kosovë dhe gjetkë.

Rëndësia e punimit qëndron në atë se është bërë një analizë e gjerë e këtij sektori, respektivisht dukurive që e karakterizojnë atë, si zhvillimi i tij, si premtimet nëpër fushatat zgjedhore për këtë sektor, si financimi, korniza legjislative, korrupsioni që e karakterizon, politizimi e shumë aspekte të tjera.

Përfundimet e punimit tregojnë se strukturat vendimmarrëse të Kosovës duhet të punojnë me më shumë zell për të strukturuar një sektor shëndetësor të suksesshëm dhe efektiv për qytetarët e Republikës së Kosovës pasi që është ndër sektorët më të frekuentuar nga thuajse çdo kokë banori.

~ Metodologjia e punimit

Ky punim është realizuar dhe konsiston në atë që njihet si research desk, ku të dhënat e përdorura, të njohura si të dhëna sekondare apo dytësore janë siguruar përmes shfrytëzimit të literaturës vendore dhe asaj ndërkombëtare, dokumenteve zyrtare, programeve dhe deklaratave politike. Përmes metodës deskriptive, është bërë përshkrimi i termeve kryesore sa i përket administratës shëndetësore dhe rrugëtimit të zhvillimit të sistemit shëndetësor që nga koha e ish-Jugosllavisë e deri në ditët e sotme. Një metodë tjetër e përdorur është metoda analizës e cila është përdorur me qëllim analizimin e përmbajtjeve të marrë nga burimet e ndryshme, për të arrirë në përfundime të caktuara. Në kuadër të metodës së analizës, në veçanti është përdorur edhe metoda e analizës historike me anë të së cilës janë analizuar periudhat e ndryshme nëpër të cilat ka kaluar sistemi dhe sektori shëndetësor në Kosovë, si në periudhën para dhe pas luftës, në periudhën e pavarësimit të shtetit të Kosovës, si dhe në periudhën pandemike. Gjithashtu në hulumtim përdoret edhe

metoda e analizës interpretuese, përmes së cilës do të interpretohet legjislacioni i Kosovës në fuqi për sistemin shëndetësor, legjislacioni dhe strategjitë për sistemin shëndetësor të disa nga vendeve nga rajoni me qëllim krahasimin e karakteristikave dhe veqorive që këto shtete kanë në sektorin e shëndetësisë.

~ Hipotezat

H₁: Bashkimi Evropian ka pasur ndikim në ndryshimet që sektori shëndetësor në Kosovë ka pësuar pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe pavarësisë së shtetit.

H₂: Sektori shëndetësor në Kosovë është prioritetizuar nga udhëheqësit e Kosovës që nga viti 2008 përmes programeve politike të fushatave zgjedhore, strategjive e planeve zhvillimore, mirëpo ende nuk është bërë mjaftueshëm punë për të përmirësuar gjendjen e këtij sektori, si një nga sektorët më të rëndësishëm për zhvillimin e shtetit.

H₃: Rëndësia e sektorit shëndetësor konsiston në ofrimin e shërbimeve dhe përkujdesjes shëndetësore për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës në të gjitha nivelet e ofrimit të kujdesit shëndetësor.

~ Pyetjet hulumtuese:

- Si organizohet sistemi shëndetësor në Republikën e Kosovës, bazuar në faktin se është një nga vendet më të reja në botë?
- Cilat janë etapat nëpër të cilat ka kaluar sektori shëndetësor i Kosovës, për të arritur në nivelin e zhvillimit aktual, dhe cili ishte ndikimi i Bashkimit Evropian në këtë aspekt?
- Si u mundësua administrimi i sistemit të shëndetësisë në periudhën pandemike?

~ Përmbledhje e shkurtër e kapitujve

Kapitulli i parë bën përkufizimin mbi atë se çfarë nënkuptojmë me administrimin e sektorit shëndetësor dhe se kush merr pjesë në të, duke bërë kështu dallimin mes stafit administrativ dhe të të punësuarëve profesional si mjekët, infermierët apo laborantët, si dhe flet për rëndësinë që ky sektor ka duke u bazuar në përkufizimin teorik të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, si një nga

organet kryesore shëndetësore në botë, dhe gjithashtu për zhvillimin e hershëm të këtij sektori nga OBSH-ja pas konfliktit të vitit 1999, gjë që inicoi fillimet e ndërtimit të një shteti.

Kapitulli i dytë përfshinë analizën historike që i dedikohet ndryshimeve dhe zhvillimeve të administrimit të sektorit shëndetësor në Kosovë, duke përfshirë kështu periudhën e para luftës së vitit 1999, me qëllim krijimin e një rrjedhe kronologjike e cila pastaj fokusohet në periudhën e pas luftës dhe analizës së administrimit në këtë periudhë e deri në periudhën e pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008.

Kapitulli i tretë shtjellon analizën institucionale dhe ligjore rreth administrimit shëndetësor, ku fillimisht analizohet rëndësia e rregulloreve të UNMIK-ut pas luftës së vitit 1999, ndërsa në vazhdim paraqiten institucionet të cilat bartin administrimin e këtij sektori me Ministrinë e Shëndetësisë si udhëheqësen e tyre, financimi dhe ndryshimet në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe sektorit shëndetësor në përgjithësi ndër vite, si dhe korniza legjislativë që organizon dhe garanton funksionimin e këtij sektori.

Kapitulli i katërt paraqet një analizë krahasuese të sektorit shëndetësor me dy shtete të rajonit, Shqipëria, si një shtet që është kandidat për antarësim në Bashkimin Evropian, dhe me Kroacia që tashmë është shtet anëtar i Bashkimit Evropian.

Kapitulli i pestë ka për qëllim shtjellimin dhe krahasimin e strategjisë së Kosovës dhe strategjive nga shtetet e tjera për zhvillimin dhe ngritjen e sektorit shëndetësor. Në vazhdim të kapitullit shpalosen programet politike të partive kryesore në Kosovë dhe planet e tyre konkrete për zhvillimin e sektorit shëndetësor pas marrjes së pushtetit nga zgjedhjet qendrore, dhe në fund shtjellohet çështja e përafrimit të legjislacionit të Kosovës me atë të Bashkimit Evropian si një nga shtetet kandidate potenciale për antarësim në këtë union.

Kapitulli i gjashtë shtjellon temën e politizimit të sektorit shëndetësor në Kosovë, duke përfshirë këtu punësimet partiake dhe familjare të cilat në një mënyrë ose tjetër degradojnë administratën shëndetësore. Çështja tjetër që preket në këtë kapitull është edhe korrupsionin si dukuri e spikatur në këtë sektor, respektivisht analizohen pjesët më të ndjeshme ndaj korrupsionit në këtë sektor.

Kapitulli i shtatë shtjellon periudhën e tretë të përcaktuar nga ky hulumtim, që është administrimi i sektorit shëndetësor dhe gjendja e tij në periudhën pandemike që nga fillimi i vitit 2020, e deri në periudhën muajin nëntor të vitit 2021, duke përfshirë këtu legjislacionin e miratuar për menaxhimin e pandemisë, luhatjet në të parin e Ministrisë së Shëndetësisë, dhe destabilizimin politik që Kosova ka pasur gjatë një periudhe të tillë të vështirë për shëndetin publik.